



Efektet afatgjate të COVID-19

27 Qershor 2022

Shumica e njerëzve që kapin COVID-19 do të kenë simptome për një kohë të shkurtër dhe pastaj ndjehen më mirë brenda disa javëve. Koha që nevojitet për t'u ndjerë më mirë nga COVID-19 dallon tek secili person. Kjo varet nga ajo se sa të sëmurë keni qenë me COVID-19. Gjithashtu mund të varet se a keni ndonjë gjendje tjetër ekzistuese mjekësore.

Ka disa njerëz që përjetojnë probleme shëndetësore afatgjate pasi të kenë pasur COVID-19. Ndonjëherë COVID-19 shkakton që një person të mos ndjehet mirë për disa muaj pasi të jetë fillimisht i sëmurë. Kjo quhet 'COVID afatgjatë'. COVID-i afatgjatë mund të zgjas disa javë dhe muaj, edhe nëse personi më nuk e ka virusin.

COVID-i afatgjatë me gjasë ndodh tek njerëzit që kanë pasur COVID-19 të rëndë. Sidoqoftë, edhe njerëzit që kanë pasur infeksion të butë të COVID-19 dhe nuk kanë pasur nevojë të shkojnë në spital përsëri mund të zhvillojnë COVID afatgjatë.

Simptomat e COVID-it afatgjatë

COVID-i afatgjatë mund të shkakton një varg simptomash dhe mund të mos ndikon tek secili në mënyrën e njëjtë. Simptomat mund të vazhdojnë edhe pas infeksionit apo mund të kthehen tek një person edhe pasi është shëruar nga COVID-19.

Simptomat dhe gjendjet më shpesh të raportuara përfshijnë:

- plogështi
- frymëmarrje të vështirësuar
- kollitje të vazhdueshme
- dhembje gjoksi
- dhembje të nyjeve
- energji të pamjaftueshme për të ushtruar
- ethe
- kokëdhembje
- problem me memorien dhe vështirësi për të menduar qartë ('mjegull në tru')
- depresion apo ankth.

Parandalimi i COVID-it afatgjatë

Mënyra më e mire për të parandaluar COVID-in afatgjatë është për të mbrojtur vetën që të mos infektoheni me virusin COVID-19.

Vaksinimi është mënyra më e mirë për të reduktuar rreziqet nga COVID-19.

Hilumtimi sugjeron se njerëzit që janë vaksinuar kundër COVID-19 kanë më pak gjasa të raportojnë simptoma të COVID-it afatgjatë sesa njerëzit që nuk janë vaksinuar.

Për më shumë informacione

Nëse merrni rezultat pozitiv për COVID-19 më shumë se disa javë më parë dhe akoma nuk ndiheni mire, bisedoni me mjekun tuaj.

Për më shumë informacione, vizitoni health.gov.au/covid19-vaccines-languages, apo thirrni National Coronavirus Helpline në 1800 020 080. Zgjedhni opcionin 8 për shërbime përkthimi falas.